



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Fehmi Zena, zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL-së
Zyrtarët përgjegjës:	Gëzim Sahiti, zv. Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Ferizajt
Lloji i aktit:	Vendimit

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullosës (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 30 për formimin e komisionit për dhënien ne shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme te komunës për vendosjen e kioskave

I miratuar më datë: 28.02.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.03.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Komuna duhet të sigurohet që të ketë themeluar dhe funksional komisionin e ankesave.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023, ka miratuar Vendim Nr. 30 për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vendosjen e kioskave.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt është i bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 12, Ligjin Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës neni 17 si dhe Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 17.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajt me datë 28.02.2023, me 40 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Vendim Nr. 30 për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vendosjen e kioskave bëhet me qëllim të zhvillimit të procedurave lidhur me vendimin paraprak Nr. 15 të datës 31.01.2023.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Agim Aliu, gradonačelnik opštine Uroševac Xhavit Zariqi, predsedavajući Skupštine opštine Uroševac	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Fehmi Zena, zamenik generalnog sekretara MALS-a,	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana, 09.03.2023. Br.020-198
Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Gëzim Sahiti, zamenik rukovodioca Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Driton Xhafa, žlubenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Uroševac	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,

Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluka br. 30 o uspostavljanju komisije za davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne imovine opštine za postavljanje kioska

Usvojena dana, 28.02.2023.

Dostavljena na razmatranje u MALS-u dana, 01.03.2023.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Opština mora osigurati da ima osnovanu i funkcionalnu komisiju za žalbe.

Obrazloženje

Skupština opštine Uroševac, na sednici održanoj dana, 28.02.2023. godine, usvojila je Odluku br. 30 o uspostavljanju komisije za davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne imovine opštine za postavljanje kioska.

MALS, konstatuje da je odluka koju je donela Skupština opštine Đakovica zasnovana na Zakonu br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 12, Zakona br. 06/L-92 o davanju na korišćenje i razmeni imovine, članu 17, kao i Uredbi (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupaka davanja na korišćenje i razmenu nepokretne imovine, član 17.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Uroševac dana, 28.02.2023. godine, sa 40 glasova "za", 0 "protiv" i 0 "uzdržanih". Odluka br. 30 o uspostavljanju komisije za davanje na kratkoročno korišćenje nepokretne imovine opštine za postavljanje kioska, vrši se u cilju razvijanja postupaka u vezi sa preliminarnom odlukom br. 15 od dana, 31.01.2023.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.